



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

## V E N D I M

### Nr. 35, Datë 26.01.2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 152, datë 14.11.2017, e Znj. E. B., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjeve politike”, “gjinisë” e për çdo shkak tjetër, nga ana e Zyrës Arsimore Devoll dhe Drejtorit të shkollës së mesme Progër.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

## K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës<sup>1</sup>, si dhe referuar dokumentacionit të dërguar me e-mail nga ankuesja, në datën 17.11.2017, rezulton se Znj. E. B., me profesion mësuese arsimit fillor, me shkallë kualifikimi III, ka punuar pranë shkollës 9-vjeçare në Cangonj, Korçë prej datës 01.11.2008. Në datën 28.07.2015, ankuesja pretendon se i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me shkollën 9-vjeçare në Cangonj, Korçë, si pasojë e shkurtimit të vendit

<sup>1</sup> Ankuesja ka depozituar 2 formularë ankese pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për shkak se formulari i parë i ankesës kishte mangësi në informacion dhe rubrika të paplotësuara, pas njoftimit nga inspektori i çështjes, ankuesja ka dërguar me e-mail, një formular ankese (të skanuar) të plotësuar në të gjithë rubrikat e tij.

të punës. Ankuesja pretendon se është larguar padrejtësisht nga vendi i saj i punës pranë shkollës 9-vjeçare në Cangonj, Korçë, pasi drejtori i kësaj shkolle ka mbajtur në punë bashkëshorten e tij, në vend që të mbante Znj. E. B.. Në datën 22.09.2015, ajo është emëruar mësuese me kontratë me afat të përcaktuar pranë Shkollës së Mesme të Bashkuar “Abdulla Progri”, në fshatin Progër, Korçë. Referuar librezës së punës së ankueses, rezulton se marrëdhëniet e punës me Shkollën e Mesme të Bashkuar “Abdulla Progri” në fshatin Progër, Korçë janë ndërprerë në datën 22.08.2016, për shkak të përfundimit të kontratës së punës. Për sa më sipër, Znj. E. B. thekson faktin se gjendja e saj ekonomike është e vështirë, pasi ka një kredi për të shlyer, si dhe bashkëshorti i saj është invalid<sup>2</sup>, ndaj kërkon rikthim në punë. Ajo pretendon se është diskriminuar nga Zyra Arsimore Devoll dhe Drejtori i Shkollës në Cangonj, Korçë për shkak të bindjeve politike<sup>3</sup>, për shkak të gjinisë dhe për çdo shkak tjetër.

**Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 140, datë 31.10.2017, së Znj. E. B.t, Komisioneri konstatoi se :**

Në ankesën nr. 152, datë 14.11.2017, të ankueses E. B. pretendohet për diskriminim të saj, për shkak të bindjeve politike, gjinisë dhe për çdo shkak tjetër nga ana e Zyrës Arsimore Devoll dhe Drejtorit të Shkollës në Cangonj, Korçë, për shkak të largimit të padrejtë nga puna në datën 28.07.2015. Referuar formularit të ankesës së Znj. E. B., rezulton se ajo ka deklaruar se diskriminimi i saj ka ndodhur në datën **20.03.2015** dhe ajo ka marrë dijeneri për këtë diskriminim në datën **22.07.2016**.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 parashikohet se ankesa nuk pranohet, nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeneri nga i dëmtuari, për këtë fakt. Referuar formularit të ankesës rezulton se ankuesja ka marrë dijeneri mbi diskriminimin e ndodhur në datën **22.07.2016**, ndërkohë që ankesa e saj është depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën **14.11.2017**, pra më vonë se 1 vit nga momenti i marrjes dijeneri për këtë fakt.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 7, 12, 13, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe në nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

<sup>2</sup> Referuar Vërtetimit nr. datë 26.09.2017, të KMPCA Korçë.

<sup>3</sup> Ankuesja nuk ka depozituar pranë Komisionerit asnjë dokument në cilësinë e provës që të vërtetojë bindjet e saj politike.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 152, datë 14.11.2017, të ankueses E. B., pasi ankesa e saj është depozituar tej afateve ligjore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Rekomandohet që ankuesja të depozitojë padi me objekt diskriminimin e pretenduar, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONERI**

Fusha – punesim  
Shkak “bindja politike” dhe “gjinia”